

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 113/2015 “PËR URDHRIN PROFESIONAL TË MJEKUT VETERINAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtyre propozimeve është harmonizimi më i mirë i ligjit me problemet e evidentura gjatë periudhës 6 vjeçare, për zbatimin e kërkesave të këtij ligji në terren, të cilat janë diskutuar nga anëtarësia, Këshilli Kombëtar dhe komuniteti i mjekëve veterinarë, e cila do të jetë një përjasje ndaj përvojës më të mirë të urdhrave homologë, brenda dhe jashtë vendit.

Objektivat që synohen të arrihen janë garantimi i vijueshmërisë dhe konsolidimi organizativ dhe ligjor i Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar (në vijim Urdhri) në të gjitha qarqet e vendit në nivel kombëtar, me qëllim përmbushjen e misionit të tij nga mjekët veterinarë, për ruajtjen e standardeve të larta, për mbrojtjen e shëndetit e mirëqinies së kafshëve, si dhe të shëndetit publik veterinar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave.

Ky projektligj është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022, miratuar me VKM nr. 850, datë 29.12.2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Që nga ngritja e Urdhrit në vitin 2016 dhe në vijim, sipas ligjit nr.113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", janë vendosur bazat ligjore për organizimin dhe funksionimin profesional të tij.

Gjatë periudhës 6 vjeçare të funksionimit të Urdhrit, nëpërmjet zbatimit të Programit të Edukimit janë kryer një sërë trajnimesh, të cilat kanë pasur efekte pozitive në rritjen e standardeve në veprimtarinë profesionale të mjekëve dhe teknikëve veterinarë, duke garantuar kështu cilësi më të larta shërbimi për mirëqenien dhe mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik veterinar.

Për gjatë përmbushjes së misionit janë shfaqur edhe disa probleme ligjore, të cilat kanë penguar dhe vështirësuar mirëfunksionimin e Urdhrit, prandaj rishikimi dhe përmirësimi i disa neneve të ligjit nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", është një nevojë e domosdoshme që do ti shërbejë zgjidhjes së këtyre problemeve të hasura deri tani në terren.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Projektligji është në harmoni me ligjin nr.10171, datë 22.10.2009 "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë" si dhe me ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS E BE-së* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj ka gjithsej 8 nene, të cilat kanë përmbajtje si më poshtë:

Në nenin 1, propozohet që në **nenin 7 të shfuqizohet pika 2**, sepse përmbajtja e saj në ligj është e panevojshme, për faktin se përbërja e Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar është e përcaktuar qartë dhe saktë në pikën 1, gërma b), të nenit 7.

Ndërkohë profesioni i mjekut veterinar, në analogji me profesionet e tjera të rregulluara, si: profesioni i mjekut human dhe profesioni i stomatologut kanë ngjashmëri strukturore, por ndërkohë krijojnë edhe mundësi unifikuese të Ligjit Nr 113/2015: “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”, me Ligjin Nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me Ligjin Nr. 127/2014 "Për Urdhrit e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë", të cilët nuk e kanë këtë kërkesë, sipas pikës 2, neni 7, të sipër cituar.

Në nenin 1, propozohet që në **nenin 7 të shfuqizohet edhe pika 4**, pasi të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të Urdhrit përcaktohen në këtë projektligj.

Në nenin 2, propozohet që **pas nenit 7, të shtohet neni 7/1**, ku janë përcaktuar të detajuara të drejtat e anëtarit të Urdhrit, të drejta të cilat deri tani janë trajtuar në statut. Përcaktimi i tyre në ligj është diktuar si një nevojë e domosdoshme për përcaktimin e përfitimeve profesionale të mbrojtura me ligj që gëzon mjeku veterinar nga anëtarësimi në Urdhër.

Në nenin 3, propozohet që pas nenit 9, të shtohet neni 9/1, ku përcaktohen të detajuara detyrimet e anëtarit të Urdhrit, detyrime të cilat deri tani janë përcaktuar në statut dhe përcaktimi i tyre në ligj është diktuar si një nevojë e domosdoshme për rritjen e përgjegjësisë së tij në përmbushjet e këtyre detyrave.

Në nenin 4, propozohet që në **nenin 14 të ndryshohen pikat 1, 2 dhe 4**:

Në pikën 1, propozohet ulja e numrit të Këshillit Kombëtar nga 21 në 12 anëtarë, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, e nevojshme kjo për faktin e përfaqësimit të zgjedhurve në raport me numrin e kufizuar të anëtarësisë, si edhe për analogji me urdhrat e tjera, ky përfaqësim është i lartë dhe një kosto për Urdhrin.

Ulja e numrit nga 4 në 3 i anëtarëve, përfaqësues të institucioneve të tjera, bëhet për shkak të ruajtjes së raporteve të numrit e anëtarëve të zgjedhur dhe numrit e anëtarëve me delegim.

Gjithashtu bëhet zëvendësimi i drejtuesit të Autoritet Kombëtar të Ushqimit me drejtuesin e Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për shkak të raportit të lartë të anëtarëve në Urdhër, që përfaqësojnë veterinerët e punësuar në këtë institucion.

Në pikën 2 dhe 4, propozohet zgjatja e mandateve efektive për Këshillin Kombëtar, Presidentin dhe Zëvendëspresidentin nga tre në pesë vjet, që do të krijojë rritje të qëndrueshmërisë dhe stabilitet të strukturave të Urdhrit, në përmbushjen e misionit ligjor për ruajtjen e standardeve të larta profesionale.

Zgjatja e mandatit efektin nga tre në pesë vjet është i nevojshëm edhe për shkak të vështirësive dhe paralizës totale gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, të cilat kanë ndikuar negativisht në ushtrimin e veprimtarisë normale të institucionit gjatë mandatit të dytë dhe të reflektuara këto në pamundësi organizative dhe teknike, për përmbushjen e objektivit kryesor të ligjit, formalizimin e Urdhrit, ku parësore janë evidentimi dhe përfundimi i anëtarësimit të të gjithë mjekëve zyrtarë, privatë, farmacistëve veterinarë, regjistrimi i teknikëve veterinarë e teknikëve të ndërzimit si dhe përfshirja në programin e edukimit dhe certifikimit profesional i tyre në nivel kombëtar, të cilët janë ende informale në tregun e punës veterinare.

Zgjatja e mandatit nga tre në pesë vjet, do të bënte ekuivalentimin tij edhe me mandatet e urdhrave të tjerë homologe të vendit, siç janë Urdhri i Mjekut Human, Urdhri i Infermierit, Urdhri i Stomatologut, Urdhri i Farmacistit, Urdhri i Psikologut, të cilët janë me mandat mbi 3 vjeçar.

Ndërkohë kjo përvojë është edhe në rajon edhe më gjërë si: Oda Veterinare Kosovare, Dhoma Veterinare në Maqedoninë e Veriut, Urdhri Veterinar i Malit të Zi, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Slloveni, Bullgari, Hungari, Itali, Austri, Francë, Angli, Irlandë dhe në shumë shtete të tjera, të cilët janë me mandat me pesë e më shumë vite.

Në nenin 5, propozohet që në **nenin 23 të ndryshohet pika 1**, lidhur me mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit edhe për 1 vit për këto arsye:

- Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar, si ent publik jo buxhetor, me burimet financiare vjetore të deri tanishme, që janë të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë si dhe tarifat e trajnimeve, certifikimit profesional, kurset dhe shërbimet e tjera dokumentare dhe shkresore, nuk i përmbush nevojat e veta financiare për të realizuar misionin e tij ligjor.

- Referuar të dhënave të viteve 2017-2021, realizimi të ardhurave financiare në total ka qenë rreth 5.5 milion lekë/vit dhe këto të realizuara si më poshtë:

- kuota anëtarësie	500 x 6 mijë/vit.....	.3 milion
- trajnime profesionale	500 x 2 mijë/vit	1 milion
- certifikime për ushtrim profesioni	500 x 2 mijë/vit.....	1 milion
- kurse dhe shërbime të tjera dokumentare dhe shkresore.....		0.5 milion

- Përmbushja me sukses e misionit të Urdhrit, përcaktuar në nenin 3 të ligjit 113/2015: "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar": *"Ruajtja e standardeve të larta në formimin, sjelljen profesionale dhe ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit mirëqenies së kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik"* kërkon një fond vjetor prej rreth **10 milion**, ose rreth **5 milion** më shumë se të ardhurat faktike, i cili do të shërbente për kryerjen e disa aktiviteteve dhe veprimtarive profesionale shtesë dhe shumë të nevojshme, por të pa realizuara deri tani, të cilat janë:

- vendosja e një juristi pranë urdhrorit si dhe krijimi i rrjetit të koordinatorëve mbi bazë qarku, të nevojshme këto për shkak të mungesës së parashikimit në ligj i strukturave rajonale të Urdhrit, ashtu siç ishte parashikuar në projektligjin e hartuar nga PAZA, 2015, si dhe për shkak të egzistencës së strukturave të coptuara dhe të vendosura në disa institucione, përfshirë këtu edhe pushtetin lokal, të cilët do të rrisin mundësitë për të kryer në kohë dhe në mënyrë të plotë evidentimin, regjistrimin dhe futjen në skemën edukimit, certifikimit dhe të financimit të të gjithë mjekëve veterinarë zyrtarë apo privatë, që nga rreth 1250 vetë të evidentuar gjithsej në nivel kombëtar janë të formalizuar deri tani rreth 700 vetë;
- ngritja e Portalit të Edukimit do të përmirësojë treguesit cilësorë të zhvillimit të Programit të Edukimit në Vijimësi si dhe do të zgjerojë gamën e tematikës së trajnimit të mjekëve veterinarë, sipas interesave e fushave të aktivitetit profesionalë;
- kryerja e aktiviteteve të tjera të domosdoshme, që i ngarkon ligji, si organizimi i veprimtarive me karakter profesional, promovime të figurave veterinarë etj.;
- shkëmbimi i përvojës me urdhrat homologë rajonalë dhe europianë, pjesëmarrja dy herë në vit në Asamblenë e Përgjithshme të Federatës Veterinarë Europiane (FVE) si dhe në Unionin Europian të Veterinerëve Praktik (UEVP), detyrime këto që burojnë nga qenia anëtar i Urdhrit në këto organizata të rëndësishme veterinarë.
- vendosja e Urdhrit në kushte barazie me urdhrat e tjerë si: Urdhrin e Mjekut Human, Urdhrin e Infermierit e të tjerë, që janë mbështetur me financim më shumë se një vit;
- mbështetur në njohjen e gjendjes aktuale të shërbimit veterinar, në draftligjin hartuar nga projekti PAZA për Urdhrin Veterinar, propozohet që financimi nga shteti të bëhet për dy vite edhe për shkak të coptimit të strukturave, të infrastrukturës së dobët të zonave rurale;
- situata tejet e vështirë që nga fundi i vitit 2019 dhe në vijim, për shkak të pandemisë së Covid-it, ka krijuar pengesa dhe pamundësi serioze për organizimin, lëvizjen dhe grumbullimin dhe realizimin e aktiviteteve të planifikuara me mjekët veterinarë, të cilat kanë qenë edhe një burim i munguar të ardhurash për Urdhrin;
- shtesat dhe ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, ku përfshihet dhe kërkesa për mbështetje buxhetore në formë transferte me një vlerë prej rreth 10 milion lekë, janë shumë të nevojshme për urdhrin, sepse ato do të mundësonin zgjidhjen e disa prej problemeve të ndeshura realisht dhe të parashtruara më lart, deri në formalizimin dhe konsolidimin organizativ dhe ligjor të tij, i cili kërkon ende kohë.

Në **nenin 6**, propozohet që organizimi i zgjedhjeve të reja të Urdhrit të bëhet brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Në **nenin 7**, përcaktohet hyrja në fuqi e ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANETQË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si ministria përgjegjëse për shërbimin veterinar, nëpërmjet grupit të punës të ngritur me Urdhrin nr. 607, datë 1.12.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e projektligjit ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 113/2015 ‘Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar’,” ka përgatitur këtë projektligj në bashkëpunim me Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar, sipas propozimeve të vetë Urdhrit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj ka efekte financiare lidhur me mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit edhe për 1 vit të Urdhrit.

MINISTËR

FRIDA KRIFCA